

**STATUT**  
**I**  
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“ AURORA BEAUTY ” SHPK**

**KREU I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Selia**

**Neni 1: Data e themelimit, Emri dhe Themeluesi**

Sot më datë 26.03.2021, une ortaku i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me emrin “**AURORA BEAUTY ” SHPK**, formuloj Statutin e saj, si më poshtë vijon ne perputhje me ligjin 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, ne zbatim te nenit 30 te ketij ligji.

Ortaket e shoqërisë jane:

1. **Luca D`Ambrosio**, shtetas italian, lindur ne Itali, i datëlindjes 20.07.1982, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi karte identiteti italiane AY 9611337
2. **Laura Mason** , shtetase italiane, lindur ne Itali, e datëlindjes 24.12.1980, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi karte identiteti italiane AX 6617063
3. **Anila Çupi**, shtetase shqiptare, lindur ne Guri i Bardhe, e datëlindjes 14.06.1988, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi karte identiteti I85614076E

**Neni 2: Objekti**

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj si vijon:

Tregtim te produkteve kozmetikes dhe bukurise, parfumeve, make up, kremra te ndryshem, produkteve estetike, detergjente te ndryshem, produkteve te pastrimit , madje edhe ne nivel industrial, bizhuteri, etj.

Tregtim artikuj te ndryshem konfeksione, veshje te ndryshme per burra gra dhe femije.

Shitje ne internet, tregti elektronike on-line, tregtim me shumice e pakice ne dyqane si dhe ne dyqan ambulant te tille si karavanet, ne Shqiperi dhe jashte vendit.

Sherbime pastrimi per individe dhe kompani, prfshire dezifektimin te mjediseve.(COVID-19)

Për të vetmin qëllim të arritjes së objektit të lartpërmendur, shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e objektit të shoqërisë, midis të tjerash të blejë interesa, aksione, pjesëmarrje të kapitalit, në shoqëri të tjera, konsorciume ose kompani të cilat kanë objekte të ngjashme apo analoge me të vetin dhe të kryejë të gjitha veprimet komerciale, industriale, financiare. Në vecanti, shoqëria, mund të marrë në pronësi, uzufukt ose qera, kompani ose dege kompanish që operojnë në fushën e një ose më shumë prej veprimtarive të mësipërme.

Gjithmone, për të vetmin qëllim të arritjes së objektit të lartpërmendur, shoqëria mundet gjithashtu të japë garanci, garanci mbi kreditë dhe depozitat, le lere peng të mira dhe vlera të tundshme, të vendosë garanci hipotekore mbi të mirat e patundshme dhe të tundshme të regjistruara, dhe të vendosë në përgjithësi çdo garanci të mundshme reale dhe personale.

### **Neni 3: Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

### **Neni 4: Selia**

Selia e shoqërisë do të jetë:

**Arapaj, Rruga Ullishtja, Zona Kadastrale 1031, Godine me nr. Pasurie 270/19, Durrës.**

Firma mund të krijojë edhe vende të tjera operative, filiale dhe agjenci në të gjithë territorin e Shqipërisë.

## **KREU II**

### **Kapitali i regjistruar**

#### **Neni 5: Vlera dhe pagesat e kapitalit të regjistruar**

Kapitali i shoqërisë është **10.000**(dhjetemije) lekë, i ndarë në 3 kuote.

Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

**Luca D'Ambrosio** është zotërues i 1 kuote, me 60 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë me vlere 6.000 leke.

**Laura Mason** është zotërues i 1 kuote, me 20 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë me vlere 2.000 leke.

**Anila Çupi** është zotërues i 1 kuote, me 20 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë me vlere 2.000 leke.

#### **Neni 6: Kalimi i kuotave**

Kuotat e kapitalit mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a.kontributit ne kapital
- b.shitblerjes
- c.trashegimise
- d.dhurimit
- e. cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj

#### **Neni 7: Zmadhimi e zvogëlimi i kapitalit themeltar**

Asambleja e Ortakeve, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakut ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme.

Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme.

### **Kreu III**

#### **Asambleja e përgjithshme**

#### **Neni 8: Të drejtat dhe detyrimet**

Asambjeja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë,
- b) ndryshimet e statutit,

- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve,
- d) emërimin dhe shkarkimin e likuidatorëve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar,
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë,
- f) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit,
- g) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre,
- h) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj adminsitatorëve,
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë,
- j) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë,
- k) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

#### **Neni 9: Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme**

- a) Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori të paktën 2 herë në vit, për të miratuar përkatësisht bilancin vjetor të mbyllur dhe bilancin vjetor parashikues.
- b) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nëpërmjet një shkrese dërguar çdo ortaku me postë të zakonshme ose mesazh elektronik. Njoftimi duhet të kryhet të paktën 7 ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen.
- c) Ortakët, që zotërojnë të paktën 5% të kapitalit të regjistruar kanë të drejtë të thërrasin mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet administratorit ose edhe pa ndërmjetësimin e tij.

#### **Neni 10: Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme**

- a) Mbledhja e Asamblesë është e vlefshme nëse në të marrin pjesë ortakë që zotërojnë më shumë se 30% të aksioneve, për të vendosur për çështje të zakonshme. Në këtë rast vendimi i Asamblesë është i vlefshëm nëse është votuar nga shumica e votave të ortakëve pjesmarrës.
- b) Mbledhja e Asamblesë, për të vendosur për çështje të veçanta si: ndryshimi i statutit, zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit të regjistruar, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, është e vlefshme nëse në të marrin pjesë ortakë që zotërojnë më shumë se 50% të kuotave. Në këtë rast

vendimi i Asamblesë është i vlefshëm nëse është votuar nga jo më pak se tre të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës.

- c) Mbledhja e Asamblesë drejtohet nga administratori nëse është e thirrur prej tij. Nëse Asambleja e Përgjithshme është thirrur nga pakica, atëherë ajo kryesohet nga njëri nga ortakët e zgjedhur nga pjesëmarrësit në atë mbledhje.
- d) Administratori pavarësisht se nuk është ortak, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marri fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.

#### **Neni 11: Votat e Pjesëmarrësve**

- a) Çdo ortak ka të drejta vote në përfaqësim me vlerën nominale të kuotes së tij.
- b) Asnjë ortak nuk voton në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet, që kanë të bëjnë me kuotat, që ai disponon.

#### **Neni 12: Emërimi i Administratorit**

- a) Administrimi si dhe përfaqësimi i shoqërisë i besohen një Administratori të vetëm që mund edhe të mos jetë ortak.
- b) Administratori i vetëm emërohet maksimumi për 5- vjet nga regjistrimi i shoqërisë pranë QKR-se, me të drejtë riperteritje, me përjashtim doreheqje apo shkarkimi nga ana Asamblese.
- c) Detyra e Administratorit të vetëm i ngarkohet z. **Anila Çupi**, për një afat 5-vjeçar, të cilit i jepet e drejta e firmes dhe e përfaqësimit të shoqërisë.

#### **Neni 13: Kompetencat e Administratorit**

Administratori ka të drejtë dhe detyrohet:

- a. të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme,
- b. të përfaqësojë shoqërinë,
- c. të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë,
- d. të bëjë të mundur përgatitjen nga specialisti i ngarkuar dhe të nënshkruajë bilancin vjetor parashikues për vitin e ardhshëm, për tu miratuar nga Asambleja e Përgjithshme, brenda datës 20 tetor të vitit paraardhës.

- e. të bëjë të mundur përgatitjen nga specialisti i ngarkuar dhe të nënshkruajë bilancin vjetor të mbyllur, për tu miratuar nga Asambleja e Përgjithshme, brenda dates 20 mars të vitit të ardhshëm dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim,
- f. të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë,
- g. të kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë,
- h. të raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare,
- i. të kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe statut.

#### **Neni 14: Mbledhjet e Administratorit**

Administratori kujdeset që në libra të posaçëm të mbajë proces verbalet e të gjitha takimeve të kryera nga ai, si dhe të gjitha mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.

### **KREU VI**

#### **Shpërndarja e fitimit vjetor të shoqërisë**

##### **Neni 15: Shpërndarja e fitimit vjetor**

- a) Pjesa e fitimit që i takon secilit ortak nga vlera e fitimit vjetor të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë, vendoset të shpërndahet nga asambleja e përgjithshme.
- b) Asambleja e Përgjithshme ka kompetencë t'u shpërndajë ortakëve pjesën e fitimit në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që kuotat e secilit ortak përfaqësojnë.
- c) Po ashtu, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë që një pjesë e fitimit vjetor të mos u shpërndahet ortakëve, por këto shuma të përdoren për zmadhimin e kapitalit fillestar apo për qëllime të tjera, të cilat ajo i konsideron të dobishme për shoqërinë.

### **KREU VII**

#### **Prishja dhe njoftimet**

##### **Neni 16: Prishja dhe likuidimi**

- a) Në rast të likuidimit të shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme emëron një likuidator, i cili administron shoqërinë deri në mbylljen e procesit të likuidimit.
- b) Me vendimin e posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicë të kualifikuar, pasi janë shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditorëve të shoqërisë, likuidatori shpërndan pjesën e mbetur të pasurisë së shoqërisë ndërmjet ortakëve. Kjo shpërndarje e fundit bëhet në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që kuotat e secilit ortak përfaqësojnë.

#### **Neni 17: Ftesa për kreditorët**

Likuiduesit duhet të ftojnë kreditorët për të depozituar pretendimet e tyre për prishjen e saj. Shoqëria e publikon dy herë këtë njoftim, me një interval prej 30 ditësh, në faqen e saj të internetit, si dhe në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Në njoftim duhet deklaruar se pretendimet duhet të depozitohen brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të fundit.

#### **Neni 18: Përfundimi i likuidimit**


- a) Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë
- b) Veprimtaria e likuiduesit nuk mund të kundërshtohet pas çregjistrimit të shoqërisë nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

#### **Neni 19: Dispozitat e fundit**

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me normat e këtij statuti.

Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKR-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Ortakët e Shoqërisë:

**Luca D'Ambrósio**  


**Laura Mason**  


**Anila Çupi**  
